

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

11 mars 2015, Prizren

Komunikatë #18

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit: Një vit, asnjë takim

Gjatë kësaj jave mbushet një vit që prej se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrë vendim për krijimin e Task Forcës për Qendrën Historike të Prizrenit.

Task Forca e krijuar më 13 mars 2014, në përbërje ka përfaqësues të MMPH-së, ministrisë së Kulturës, asaj të Administrimit të Pushtetit Lokal, ministrisë së Punëve të Brendshme, Komunës së Prizrenit dhe Këshillit për Trashëgimi Kulturor, dhe ka për qëllim zbatimin e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Komunikata e MMPH-së, <http://mmp-h-rks.org/sq/Lajmet/Edhe-nje-Taske-Force-per-Qendren-Historike-te-Prizrenit-857>).

Mirëpo në vitin e parë të ekzistimit të saj, kjo Task Forcë nuk është mbledhur asnjëherë, dhe kësaj nuk ka pas se si të marrë vendime apo veprime konkrete në trajtimin e rasteve të dëmtimit të trashëgimisë kulturore, ndërtimeve pa leje dhe parregullsive tjera. Ndërkohë degradimi në Qendrën Historike të Prizrenit ka vazhduar pa u penguar nga institucionet që kanë përgjegjësi ligjore për veprim. Madje gjatë kësaj periudhe, janë evidentuar disa raste kur vet Komuna e Prizrenit ka realizuar projekte pa i përfillur procedurat e parapara me dispozitat e ligjeve të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor.

Raporti statistikor i Prokurorisë Themelore në Prizren për ndërtimet pa leje, tejkalime të lejeve, rrënim e dëmtim të monumenteve në Qendrën Historike të Prizrenit, vë në pah numrin e vogël të aktakuzave të ngritura. Sipas të dhënave të Prokurorisë del se në vitin 2014 janë bërë 7 kallëzime penale, ku 2 raste janë në hetime, 1 rast është hedhur, derisa në 2 raste janë pushuar hetimet. Ndërsa Gjykata Themelore e Prizrenit ka bërë të ditur se nuk ka asnjë lëndë në shqyrtim sa i përket dëmtimit të monumenteve në Qendrën Historike të Prizrenit.

Duke marrë parasysh faktin se kemi hyrë në vitin e tretë që prej se është miratuar Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit si dhe në vitin e dytë të ekzistimit të Task Forcës për Qendrën Historike të Prizrenit, atëherë shumë lehtë konstatohet se institucionet përgjegjëse aprovojnë ligje dhe krijojnë mekanizma për planifikim urban dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore pa e qarë fare kokën për zbatimin dhe funksionalitetin e tyre në vendosjen e rendit urbanistik dhe ruajtjen e vlerave të rëndësishme kulturore e historike.

Me qasjen e deritanishme respektivisht me miratimin e ligjeve dhe krijimin e mekanizmave të reja institucionet e nivelit qendror kanë dëshmuar se janë të interesuara që të krijojnë vetëm më shumë burrokraci e më pak veprime në terren. Në të njëjtën kohë kanë krijuar alibi për mosveprimin shumëvjeçar të komunës së Prizrenit në zbatim të ligjit për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike.

EC Ma Ndryshe i bën thirrje të gjitha institucioneve që janë pjesë e Task Forcës që të iniciojnë funksionalizimin sa më të shpejtë të këtij mekanizmi dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete për vendosjen e ligjshmërisë në Qendrën Historike të Prizrenit, duke mundësuar ruajtjen efikase të trashëgimisë kulturore.

“EC Ma Ndryshe” në korrik të vitit 2013 ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Projekti do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjësisë institucionale.

*Me nderime,*

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &

Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

The logo for SOROS, featuring the word "SOROS" in a bold, sans-serif font. The letter "O" is replaced by a stylized blue and white circular graphic that resembles a globe or a network of connections.

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo